



Mundësitë e arsimimit në Kantonin Thurgau

Përmbajtja

Shkurtimisht pikat më të rëndësishme	3
Ofertat për nxitimin parashkollor	4
Kopshti i fëmijëve	4
Shkolla e shkallës së parë	5
Shkolla e shkallës së dytë	5
Shkollimi special	5
Ofertat ndërlidhëse / kurse të integritit	6
Arsimimi profesional bazë	7
• Matura profesionale	
• shkolla e mesme e shkencave kompjuterike	
• Provimi «Passerelle»	
Shkollat e maturës	8
• Shkollat gjimnaz me maturë	
• Shkolla e mesme e specializuar dhe matura e specializuar	
Arsimimi profesional i ngritur	9
• Provimet e Konfederatës (provimi i zanatit BP dhe provimi i ngritur profesional HFP)	
• Shkollat e ngritura profesionale	
• Shkollat e tjera të ngritura profesionale	
Shkollat e larta	10
• Shkolla e Lartë Pedagogjike Thurgau	
• Shkolla të tjera të larta	
Kualifikimet i mëtejshme	11
Ofertat shoqëruese për të gjitha shkallët e arsimimit	11
Arsimimi i prindërve	11
• Psikologjia shkollore dhe logopedia	
• Konsultimi për zanatin dhe studimet	
• Kontribute për arsimimin profesional dhe kontribute në shkolla jashtë Kantonit	12
• Informacione të tjera dhe institucione ku mund të drejtohesh	12

DËFTUES BOTIMI

Botuesi

Departamenti për Edukim dhe Kulturë

Botimi i 4-të, janar 2018

Broshura qëndron në dispozicion si Download në shqip, arabisht, anglisht, frëngjisht, italisht, polonisht, portugalisht, serbokroatisht, sllovakisht, spanjisht, tamilisht, turqisht dhe hungarisht nën gsdek.tg.ch → Publikationen und Downloads → Bildung.

Redaksia

Sekretaria e Përgjithshme e Departamentit për Edukim dhe Kulturë
Enti për Shkollën Popullore
Enti për Shkollat e Mesme dhe të Larta
Enti për Arsimimin Profesional dhe Konsultimin për Zanat

Konceptimi dhe formimi

Joss & Partner Werbeagentur AG, Weinfelden

Parafjala

Të dashur prindër

Të nderuar zonja dhe zotërinj

Për fëmijët dhe të rinjtë shkolla është një nga stacionet më të rëndësishme të jetës në dy dekadat e para të jetës. Shkolla, mësuesit, shokët e klasës – ata të gjithë janë të rëndësishëm dhe gjurmëlënës në fëmijëri dhe rini deri në moshën e pjekurisë. Duke ditur këtë, dëshira jonë është, që ju të jeni informuar plotësisht për sistemin arsimor e Kantonit Thurgau për të qenë në gjendje të këshilloni dhe të shoqëroni fëmijën tuaj nëpër karrierën e saj shkollore. Broshura e parashtruar t'ju ndihmojë që ju të orientoheni në peizazhin arsimor në Kantonin Thurgau.

Ju si prindër keni një rol të rëndësishëm në lidhje me ndjekjen e shkollës së fëmijës suaj. Me anë të një bashkëpunimi të mirë me shkollën dhe me mësuesin e fëmijës suaj ju mund të kontribuoni shumë për një zhvillim të mirë shkollor të fëmijës suaj.

Veç informacioneve për sistemin arsimor të Kantonit Thurgau, broshura e parashtruar përmban edhe shumë njoftime për oferta të tjera informacionesh dhe kurseesh. Do të gëzoheshim, në qoftë se ata do të zgjonin interesin tuaj dhe ju t'i shfrytëzonit ata.

Këshilltarja e Qeverisë

Monika Knill

Shkurtimisht pikat më të rëndësishme

Ndjekja e shkollës popullore është e detyrueshme dhe përfshin 11 vjet. Ndjekja e një shkolle publike është falas për të gjithë fëmijët dhe adoleshentët, që banojnë në Kantonin Thurgau.

Koha e detyrueshme shkollore fillon me dy vjet kopsht fëmijësh. Në vijim fëmijët ndjekin gjatë gjashtë viteve shkallën e parë. Pastaj vjen shkalla e dytë I, e cila zgjat tre vjet. Mbas shkallës së dytë I koha e detyrueshme shkollore ka mbaruar.


Në vijim adoleshentëve u ofrohen rrugë të ndryshme në shkallën e dytë II. Rreth dy e treta e adoleshentëve ndjekin një kurs zanati, i cili i kualifikon ata për ushtrimin e profesionit të zgjedhur. Në shtesë të kursit të zanatit, adoleshentët me nota të mira mund të mbrojnë një maturë profesionale dhe të fitojnë kështu hyrjen e drejtpërdrejtë për një shkollë të lartë profesionale (shkalla e tretë).

Rreth një e treta e adoleshentëve ndjek në shkallën e dytë II një arsimim shkollor në një gjimnaz ose në një shkollë të mesme të specializuar, të cilat përgatitin për degë të arsimit profesional në shkallën e tretë.

Me një diplomim në shkallën e dytë II mund të ndiqen në shkallën e tretë shkolla të ndryshme të larta – në varësi, nëse u përfundua një kurs zanati, një maturë profesionale ose një arsimim shkollor në një gjimnaz ose në një shkollë të mesme të specializuar.

PËRSHKUESHMËRIA E MADHE E SISTEMIT ARSIMOR

Sistemi arsimor zviceran shquhet për një përshkueshmëri të madhe: Ka rrugë të ndryshme për të hyrë apo për të kaluar në një arsimim ose në një shkollë ose për të ndjekur dhe për të përfunduar një arsimim me vonesë. Ofertat për nxitimin parashkollor dhe koha e detyrueshme shkollore



Ofertat për nxitimin parashkollor

Të mundësohet një nisje optimale

Në radhë të parë prindërit kanë përgjegjësinë për edukimin e fëmijëve të tyre. Familja është vendi i parë dhe më i rëndësishëm për nxitjen e hershme. Fëmijët e vegjël dhe familjet e tyre përkrahen në rast nevojë me oferta për arsimimin në fëmijërinë e hershme, me kujdestari dhe edukim. Këtu përfshihen konsultimi i nënave dhe të baballarëve, konsultimi për edukimin dhe arsimimi i prindërve si dhe oferta kujdestarie dhe grupe lojërash plotësuese për familjen.

Përvoja mësimi në vitet e parë të jetës janë bazë për të gjitha proceset e mëvonshme të mësimi. Në lidhje me ndjekjen e shkollës ka një rëndësi të veçantë për fëmijë me gjuhë amtare të huaj, që ata të mësojnë gjuhën gjermane. Një mundësi e mirë për këtë janë grupet e lojërave gjuhësore, të cilat janë konceptuar veçanërisht për fëmijë me sfond migrimi. Por edhe qëndrimi në një çerdhe fëmijësh ose në një grup lojërash jep një kontribut të rëndësishëm për mësimin e gjuhës gjermane.

ofertat/kontakti

Oferta të veçanta gjinden nëpër kësaj faqeje interneti:
www.familienplattform-ostschweiz.ch
ose pyesni drejtpërdrejt tek komuna juaj shkollore ose banimi.

Kopshti i fëmijëve

Hapësirë për të luajtur, për të marrë përvoja dhe për të mësuar

Çfarë i përket organizimit dhe pedagogjikes, kopshti i fëmijëve si niveli fillestar i arsimimit është lidhur ngushtë me shkollën e shkollës së parë. Në kopshtin e fëmijëve mësohet sipas parimeve të tërësisë. Duke u marrë gjatë lojës me shqisat, me të menduarit dhe me ndjenjat, fëmija drejtohet drejt të mësuarit të orientuar sipas qëllimeve në shkollën e shkollës së parë dhe me anë të kësaj fiton parakushtet për mësimin e të lexuarit, e të shkruarit dhe e të llogariturit. Fëmijëve me deficite zhvillimi u jepet në dispozicion një ofertë të gjerë përkrahjeje.

grupmosha

fëmijë në moshën 4–6 vjeç. Fëmijët të cilët kanë mbushur 4 vjet deri në datën 31 korrik, janë të detyruar të ndjekin kopshtin e fëmijëve që nga fillimi i vitit të ri shkollor. Prindërit mund të deklarojnë shtyrjen e hyrjes për një vit.

kohëzgjatja

2 vjet

madhësia e klasës

madhësia e zakonshme: 20 nxënës dhe nxënës

orari mësimor

të hënën deri të premten, të paktën mbasditja e të mërkurës pushim 20–24 leksione javore (në varësi të moshës së fëmijës)

vendi i shkollës

Kopshti i fëmijëve duhet të ndiqet në po atë komunë shkollore, ku fëmija banon. Nëse një fëmijë në moshën e detyrës shkollore nuk ndjek një kopsht publik, drejtorisë arsimore të komunës së banimit duhet t' i vërtetohet një ndjekje përkatëse diku tjetër.

oferta nxitjeje përkrahjeje

Për fëmijët, oferta të ndryshme nxitjeje plotësuese dhe përkrahëse qëndrojnë në dispozicion dhe si logopedi, psikomotorikë ose kurse për Gjermanisht si Gjuhë e Dytë dhe në lëndën Gjuha dhe Kultura Tradicionale e Vendit.

kontakti

Amt für Volksschule, Spannerstrasse 31, 8510 Frauenfeld
Telefoni 058 345 57 70, av.tg.ch

Shkolla e shkallës së parë

Bazat për një të mësuarit gjatë gjithë jetës

Shkolla e shkallës së parë ka një detyrë arsimimi dhe edukimi sipas parimit të tërësisë. Ajo përcjell njohuri dhe zotësi të rëndësishme dhe themelore, nxit aftësitë individuale mendore, artistike dhe fizike të fëmijëve dhe i edukon ata për një të vepruarit me mëvetësi dhe përgjegjshmëri në shoqëri. Nxënëset dhe nxënësit zhvillojnë kompetenca për t'u informuar dhe për të mësuar gjithnjë më shumë në mënyrë të pavarur.

Me anë të kësaj, shkolla e shkallës së parë vë një themel të rëndësishëm për shkollimin e mëtejshëm.

grupmosha

fëmijë në moshën 7 – 12 vjeç. Shkolla e shkallës së parë fillon në vijim të dy viteve të kopshtit të fëmijëve.

kohëzgjatja

6 vjet

madhësia e klasës

madhësia e zakonshme: 24 nxënëse dhe nxënës

orari mësimor

të hënën deri të premten, mbasditja e të mërkurës pushim
klasat 1 dhe 2: 24 leksione secila
klasa 3: 29 leksione
klasat 4 deri 6: 30 leksione secila

vendi i shkollës

Kopshti i fëmijëve duhet të ndiqet në po atë komunë shkollore, ku fëmija banon. Nëse një fëmijë në moshën e detyrës shkollore nuk ndjek një shkollë publike, drejtorisë arsimore të komunës së banimit duhet t'i vërtetohet një shkollim përkatës diku tjetër.

oferta nxitjeje

Për fëmijët, oferta të ndryshme nxitjeje plotësuese dhe përkrahëse qëndrojnë në dispozicion dhe përkrahjeje si klasa përgatitore, klasa të posaçme, logopedi, psikomotorikë ose kurse për Gjermanisht si Gjuhë e Dytë dhe në lëndën Gjuha dhe Kultura Tradicionale e Vendit. Për studentët veçanërisht të interesuar dhe të talentuar ofrohen seminare të veçanta dhe ditë impulsesh.

kontakti

Amt für Volksschule, Spannerstrasse 31, 8510 Frauenfeld
Telefoni 058 345 57 70, av.tg.ch

Shkolla e shkallës së dytë

Të gjithë rrugën arsimore që të të përshtatet ty

Nxënëset dhe nxënësit zgjerojnë dhe thellojnë njohuritë dhe zotësitë të fituara në shkollën e parë dhe nxiten në zhvillimin e tyre dhe në formimin e personalitetit të tyre. Veç kësaj, adoleshentët përkrahen në zgjedhjen e rrugës së tyre të mëtejshme profesionale ose shkollore (shkolla e dytë II).

Mësimi në shkollën e dytë I ofrohet në nivele të ndryshme aftësie.

grupmosha

fëmijë në moshën 13 – 16 vjeç.

kohëzgjatja

3 vjet (kalimi tek shkollat me maturë mbas 2 vjetësh është i mundur)

madhësia e klasës

madhësia e zakonshme: 24 nxënëse dhe nxënës

orari mësimor

të hënën deri të premten, një mbasditë pushim
klasa 1: 33 leksione
klasa 2: 33 leksione
klasa 3: 31–33 leksione eventualisht lëndë të lira shtesë

vendi i shkollës

Shkolla e shkallës së dytë duhet të ndiqet në po atë komunë shkollore, ku nxënësja ose nxënësi banon. Nëse një fëmijë në moshën e detyrës shkollore nuk ndjek një shkollë publike, drejtorisë arsimore të komunës së banimit duhet t'i vërtetohet një shkollim përkatës diku tjetër.

oferta nxitjeje përkrahjeje

Për fëmijët, oferta të ndryshme nxitjeje plotësuese dhe përkrahëse qëndrojnë në dispozicion dhe si klasa të posaçme, logopedi, psikomotorikë ose kurse të gjermanishtes për persona me gjuhën amtare të huaj, kurse në gjuhën dhe kulturën tradicionale e vendit, nxitja e nxënësve me dhunti në fizikulturë, muzikë, vallëzim si dhe konsultimi për profesion dhe studime. Për studentët veçanërisht të interesuar dhe të talentuar ofrohen seminare të veçanta dhe ditë impulsesh.

kontakti

Amt für Volksschule, Spannerstrasse 31, 8510 Frauenfeld
Telefoni 058 345 57 70, av.tg.ch

Shkollimi special

Nxitja e fëmijëve me nevojë të veçantë nxitjeje

Tek arsimimi i fëmijëve dhe i adoleshentëve me aftësi të kufizuara fizike, shqisore ose mendore ka oferta, që janë formuar posaçërisht për nevojat e tyre.

Po të jetë e mundur, fëmijët me aftësi të kufizuara ndjekin shkollën normale në vendin e banimit dhe si të gjithë fëmijët e tjerë janë të integruar në shkollën e rregullt. Këta fëmijë përkrahen me pedagogji kuruese ose në mënyrë tjetër. Komuna shkollore vendos për zhvillimin e një ashtuqajturit Shkollimi Special Integruar.

Kur një Shkollim Special Integruar nuk është i mundur, fëmijët përkatës ndjekin një shkollë speciale. Shkollat speciale janë të specializuara për forma të veçanta të aftësisimit të kufizuar ose për vështirësi në të mësuarin ose në sjellje.

kontakti

Amt für Volksschule, Fachstelle Sonderschulung
Spannerstrasse 31, 8510 Frauenfeld, Telefoni 058 345 57 70
av.tg.ch → Handbuch Volksschule → Sonderschulung

Ofertat ndërlidhëse / kurse të integrimit

Ndihma për hyrjen në profesion

Ka oferta të ndryshme për të rinjtë pa zgjidhje të vazhdueshme ose për të rinjtë që kanë boshllëqe në shkollën e tyre për shkak të sfondit të tyre të migrimit. Ato shërbejnë për t'u përgatitur për një arsim bazë ose për ndjekjen e shkollës së mesme.

OFERTAT NDËRLIDHËSE

Të rinjtë mund të thellojnë njohuritë e tyre themelore të shkollës dhe aftësitë e tyre personale në një vit përgatitor. Ato mbështeten në mënyrë specifike në procesin e zgjedhjes së tyre në karrierë. Oferta kantonale dallon midis ofertave ndërlidhëse me fokusin e shkollës (lloji A) dhe ofertat ndërlidhëse me orientim praktik (lloji P).

kohëzgjatja

1 vjet

kushtet e pranimit

lexohen në këtë faqe:

abb.tg.ch → Brückenangebote → Richtlinien

afati i regjistrimit

shkurt deri jo më vonë se 30 prill

Informacione të mëtejshme gjinden në faqet e internetit të shkollave përkatëse:

- **Brückenangebot Weinfelden:**
www.gbw.ch → Brueckenangebote
- **Brückenangebot Frauenfeld:**
www.bztf.ch → Brückenangebote
- **Brückenangebot Romanshorn:**
www.sbw.edu → Bildungsangebot → Bildungsstufen → Sekundarstufe II → SBW Brückenangebot

kontakti

Amt für Berufsbildung und Berufsberatung,
Aufnahmestelle Brückenangebote
Zürcherstrasse 285, 8510 Frauenfeld
Telefoni 058 345 59 99
abb.tg.ch → Brückenangebote

KURSE INTEGRIMI KANTONALE

Kantoni i Thurgaut realizon kurse kantonale të integrimit për të rinjtë e huaj në Thurgau. Fokusi është në mësimin e gjuhës gjermane dhe arsimin të përgjithshëm. Ky është krijimi i parakushteve për përfundimin e një trajnimit profesional (EBA ose EFZ) ose një shkolle të mesme. Për aq sa është e mundur, ekzistojnë praktika javore.

KURS INTEGRIMI 1B

Kursi i integrimit 1b ka në brendi veçanërisht mësimin e gjuhës gjermane, si dhe përballimin e jetës së përditshme.

Kushtet e regjistrimit

Mosha: 17-24 vjeç

Niveli i gjuhës gjermane: GER 0 apo A1

Kohëzgjatja

2 vjet; 8 gjysma dite në javë

Shpenzimet

Fr. 3'500.- për semester

kontakti

Amt für Berufsbildung und Berufsberatung, Schulische Bildung, Aufnahmestelle Integrationskurse, Zürcherstrasse 285, 8510 Frauenfeld
Telefon 058 345 56 91, abb.tg.ch → Integrationskurse

KURS INTEGRIMI 2

Kursi i integrimit 2 ndjek kursin e integrimit 1b dhe përcjell në veçanti përbajtjen e të mësuarit të nivelit të mesëm I.

Kushtet e regjistrimit

Mosha: 17-24 vjeç

Niveli i gjuhës gjermane: GER A2

Kohëzgjatja

1 vit; 8 gjysma dite në javë

Shpenzimet

Fr. 3'500.- për semester

kontakti

Amt für Berufsbildung und Berufsberatung, Schulische Bildung, Aufnahmestelle Integrationskurse
Zürcherstrasse 285, 8510 Frauenfeld
Telefon 058 345 56 91, abb.tg.ch → Integrationskurse

KURS INTEGRIMI 3

Kursi i integrimit 3 ndjek kursin e integrimit 2. Ai përgatit shkollën dhe praktikën për një trajnim profesional ose ndjekjen e një shkolle të mesme.

Kushtet e regjistrimit

Mosha: 17-24 vjeç

Niveli i gjuhës gjermane: GER B1

Kohëzgjatja

6 muaj deri në 1 vit; 5 ditë në javë

Shpenzimet

Nuk ka shpenzime

kontakti

Amt für Berufsbildung und Berufsberatung, Schulische Bildung, Aufnahmestelle Integrationskurse, Zürcherstrasse 285, 8510 Frauenfeld
Telefon 058 345 56 91, abb.tg.ch → Integrationskurse



Arsimimi profesional bazë

Arsimimi profesional

Një arsimim profesional bazë është themeli për të mësuarit gjatë gjithë jetës dhe hap një larmi perspektivash profesionale. Më shumë se dy e treta të adoleshentëve zgjedhin mbas kohës së detyrueshme shkollore këtë rrugë.

Ndërmarrjet ekonomike të Kantonit Thurgau sigurojnë nëpërmjet një gatishmërie të madhe arsimimi një ofertë të shumëllojshme në të gjitha fushat e profesioneve. Adoleshentët bashkëpunojnë në një ndërmarrje që ofron kurse zanati dhe ndjekin si plotësim kurset përtej ndërmarrjeve. Ata fitojnë bazat e tyre të teorisë profesionale në një shkollë profesionale të zanatit. Arsimimi profesional bazë përfundohet me një diplomë aftësie ose me një vërtetim zanati.

kohëzgjatja

Arsimimi profesional bazë me vërtetimin zanati të Konfederatës (EBA) zgjat dy vjet, arsimimi profesional me diplomë aftësie të Konfederatës (EFZ) zgjat tre ose katër vjet.

Kushti i pranimit

kontratë e vlefshme për kursin e zanatit

profesionet me kurs zanati

Informacione rreth profesioneve me kurs zanati gjinden në këtë faqe: www.berufsberatung.ch

Informacione të mëtejshme gjinden në faqet e internetit të shkollave përkatëse:

- **Bildungszentrum für Wirtschaft Weinfelden:** www.bzwww.ch
- **Gewerbliches Bildungszentrum Weinfelden:** www.gbww.ch
- **Bildungszentrum für Gesundheit und Soziales Weinfelden:** www.bfgs-tg.ch
- **Bildungszentrum für Technik Frauenfeld:** www.bztf.ch
- **Bildungszentrum für Bau und Mode Kreuzlingen:** www.bbm.tg.ch
- **Bildungszentrum Arbon:** www.bza.tg.ch
- **Bildungs- und Beratungszentrum Arenenberg:** arenenberg.tg.ch

kontakti

Amt für Berufsbildung und Berufsberatung, Betriebliche Bildung
Zürcherstrasse 285, 8510 Frauenfeld
Telefoni 058 345 59 30
abb.tg.ch → schulische Bildung → Bildungszentren

MATURA PROFESIONALE

Mësimdhënia për maturën profesionale plotëson arsimimin profesional dhe përmban një arsimim të përgjithshëm të zgjeruar me kërkesa të larta. Së bashku me një diplomë aftësie të Konfederatës (EFZ), një arsimim profesional bazë tre- ose katërvjeçar, diploma e maturës profesionale (BM) mundëson hyrjen në një shkollë të lartë profesionale (FH) pa provim. Shkolla për maturën profesionale mund të ndiqet gjatë arsimimit profesional (BM1) ose edhe mbas përfundimit të arsimimit profesional bazë (BM2).

Informacione të mëtejshme gjinden në faqet e internetit të shkollës përkatëse:

• Bildungszentrum für Wirtschaft Weinfelden:

www.bzwww.ch → Angebot

• Bildungszentrum für Technik Frauenfeld:

www.bztf.ch → Berufsmaturität

kontakti

Amt für Berufsbildung und Berufsberatung, Schulische Bildung
Zürcherstrasse 285, 8510 Frauenfeld, Telefoni 058 345 59 30
abb.tg.ch → schulische Bildung → Bildungszentren → Berufsmaturität

SHKOLLA E MESME E SHKENCAVE KOMPJUTERIKE

Trajnimi në Shkollën e Mesme të Shkencave Kompjuterike (IMS) përfshin një arsim bazë të shkollës të kombinuar me matrikulimin profesional. Fitohet edhe një shkencëtare kompjuterësh / shkencëtar kompjuterësh EFZ dhe një certifikatë profesionale për "Ekonomi të biznesit dhe të tipit të biznesit".

Informacione të mëtejshme mund të gjenden në faqen kryesore të shkollës:

• Informatikmittelschule (IMS) mit Berufsmaturität Wirtschaft

www.kanti-frauenfeld.ch → IMS

kontakti

Amt für Mittel- und Hochschulen, Grabenstrasse 11, 8510 Frauenfeld
Telefon 058 345 58 30, amh.tg.ch

PROVIMI «PASSERELLE»

Kolegji profesional i lartë dhe kolegji teknik mund të përgatiten për një provim plotësues në TSME në një kurs niel i lartë njëvjeçar me kohë të plotë, i cili gjithashtu siguron qasje në kolegjet e universitetit.

kohëzgjatja

30 javë, Nga shtatori në gusht

kushtet e pranimit

Certifikata profesionale / dëshmi pjekurie me mesatare të mirë të notave të klasës; bisedë pranimit

kontakti

Thurgauisch-Schaffhauserische Maturitätsschule für Erwachsene
Neuhauserstrasse 7, 8500 Frauenfeld
Telefoni 058 345 51 00
www.tsme.ch → Passerellenkurse

Shkollat me maturë

Rruga drejt studimit në shkollën e lartë teknike të Konfederatës ETH, në universitet, në shkollën e lartë pedagogjike dhe në shkollën e ngritur profesionale

Shkollat gjimnaz me maturë përgatitin për një studim në ETH, në universitet dhe në shkollën e lartë pedagogjike. Me maturën e specializuar hapen edhe rrugë të caktuara drejt shkollave të larta profesionale. Diploma e shkollës së mesme profesionale hap hyrjen tek shkollat e ngritura profesionale.

SHKOLLAT GJIMNAZ ME MATURË

Shkollat gjimnaz me maturë japin një arsimim të përgjithshëm të gjerë dhe përgatitin për një studim në shkollën e lartë. Arsimimi përfundohet me një maturë të akredituar brenda Zvicrës, e cila mundëson studimin në të gjitha shkollat e larta universitare të Zvicrës (universitete, shkollat e larta teknike të Konfederatës), në shkollat e larta pedagogjike si dhe pas një kohe praktike njëvjeçare edhe në shkollat e larta profesionale.

Çdo shkollë ka oferta të veçanta:

- Matura në dy gjuhë në anglisht në Shkollat Kantonale Kreuzlingen, Romanshorn, Wil
- Matura në dy gjuhë në frëngjisht në Shkollën Kantonale Frauenfeld
- Matura në dy gjuhë në frëngjisht ose italisht në Shkollën Kantonale Romanshorn
- Klasa MINT në Shkollën Kantonale Kreuzlingen për të interesuarit në matematikë, informatikë dhe shkencat e natyrës
- Shkolla pedagogjike me maturë me arsimim profesional të integruar për të interesuarit në profesione arsimore
- Klasa e artit dhe e sportit në Shkollën Pedagogjike me Maturë në Kreuzlingen për nxënës të talentuara dhe nxënës të talentuar me nota të mira në fushat sport, art dhe muzikë.
- Matura Talenta në Shkollën Kantonale Romanshorn

Informacione të mëtejshme gjinden në faqet e internetit të shkollës përkatëse:

• **Kantonsschule Frauenfeld:**
www.kanti-frauenfeld.ch → Gymnasium

• **Kantonsschule Kreuzlingen:**
www.ksk.ch → Portrait → Bildungsangebot

• **Kantonsschule Romanshorn:**
www.ksr.ch → Gymnasiale Maturitätsschule

• **Pädagogische Maturitätsschule Kreuzlingen:**
www.pmstg.ch → Matura mit Berufsbildung

• **Kantonsschule Wil (për nxënës dhe nxënës nga Hinterthurgau):**
www.kantiwil.ch → Ausbildung

kontakti

Amt für Mittel- und Hochschulen
Grabenstrasse 11, 8500 Frauenfeld
Telefoni 058 345 58 30
amh.tg.ch → Mittelschulen

SHKOLLA ME MATURË E KANTONEVE THURGAU DHE SCHAFFHAUSEN PËR TË RRRITUR

Në Shkollën me Maturë e Kantoneve Thurgau dhe Schaffhausen për të Rriturit (TSME), njerëz të rritur në punë me kushtet e duhura mund ta përfundojnë maturën me vonesë paralelisht me punën.

kohëzgjatja

7 semestra

kushtet e pranimit

Hyrja tek semestri i parë është parimisht e hapur për të gjithë personat, të cilët kanë një diplomë të shkollës së shkallës së dytë (nivel i zgjeruar) dhe që sjellin vërtetimin e një veprimtarie profesionale të paktën dyvjeçare. Kurs zanati, kohëra praktike, kohë papunësie e vërtetuar, amvisëri dhe kujdesi i fëmijëve llogariten.

kontakti

Thurgauisch-Schaffhauserische Maturitätsschule für Erwachsene
Neuhauserstrasse 7, 8500 Frauenfeld
Telefoni 058 345 51 00
www.tsme.ch → Maturitätsausbildung

Kursi «Passerelle»:

shih faqen 7

SHKOLLA E MESME E SPECIALIZUAR DHE MATURA E SPECIALIZUAR

Rruga arsimore normalisht katërvjeçare drejt maturës së specializuar përgatit për studime në shkolla të larta profesionale në degat shëndetësi, punë sociale si dhe komunikim dhe informacion. Me maturën e specializuar pedagogjike mund të studiohet në shkollën e lartë pedagogjike. Ai që nuk ka dëshirë të bëjë maturën e specializuar, mbas tre vitesh me diplomën e shkollës së mesme të specializuar mund të vazhdojë rrugën e tij arsimore në një shkollë të ngritur profesionale. Matura e specializuar pedagogjike ofrohet vetëm në Shkollën Kantonale Frauenfeld. Ka shkolla të mesme të specializuara në Shkollat Kantonale Frauenfeld dhe Romanshorn.

Më shumë informacione gjinden në faqet e internetit të shkollës përkatëse:

• **Kantonsschule Frauenfeld (Shkolla Kantonale Frauenfeld):**
www.kanti-frauenfeld.ch → FMS

• **Kantonsschule Romanshorn (Shkolla Kantonale Romanshorn):**
www.ksr.ch → Fachmittelschule

kontakti

Amt für Mittel- und Hochschulen
Grabenstrasse 11, 8500 Frauenfeld
Telefoni 058 345 58 30
amh.tg.ch → Mittelschulen



Arsimimi profesional i ngritur

Arsimimi i udhëheqësve dhe specializimi i personave profesionistë

Arsimimi i ngritur profesional përgatit për funksione specialiste ose udhëheqëse me kërkesa të larta. Ai mundëson një specializim dhe një thellim të kompetencave profesionale dhe ofron kualifikime në fushën e drejtimit të ndërmarrjeve.

Arsimimi i ngritur profesional përban:

- provimet e Konfederatës (provimi i zanatit BP dhe provimi i ngritur profesional HFP)
- degët arsimore në shkollat e ngritura profesionale (HF)

PROVIMET E KONFEDERATËS (PROVIMI I ZANATIT BP DHE PROVIMI I NGRITUR PROFESIONAL HFP)

Provimet e zanatit u mundësojnë personave profesionistë një thellim dhe specializim të parë profesional pas arsimimit profesional bazë në një zanat. Kryerja e një provimi zanati me sukses normalisht është një kusht pranimi për provimin e ngritur profesional. Ky i kualifikon persona profesionistë në fushën e tyre të profesionit si eksperte dhe ekspertë dhe i përgatit për udhëheqjen e një ndërmarrjeje.

Më shumë informacione rreth provimeve të Konfederatës gjinden në faqen e internetit të Sekretarisë së Shtetit për Arsim, Hulumtim dhe Inovacion SBFi:

www.sbf.admin.ch → Bildung → Höhere Berufsbildung → Berufsprüfungen BP und höhere Fachprüfungen HFP

SHKOLLAT E NGRITURA PROFESIONALE

Degët arsimore e shkollave të ngritura profesionale kanë një lidhje të fortë me praktikën. Problemet konkrete nga shërbimi, fabrika, punishtja dhe prodhimi janë në planë të parë. Absolventet dhe absolventët e një shkolle të ngritur profesionale futen shpesh në punë në shkallën e mesme të drejtimit.

Në Kantonin Thurgau mund të ndiqen këto degë arsimore të shkollës së ngritur profesionale: Shkolla e ngritur profesionale e kujdesit shëndetësor, shkolla e ngritur profesionale e ekonomisë dhe shkolla e ngritur profesionale e teknikës dhe e konstruksionit të makinerive.

SHKOLLA E NGRITUR PROFESIONALE E KUJDESIT SHËNDETËSOR

përfundimi

profesioniste e diplomuar në kujdesin shëndetësor HF/
profesionist i diplomuar në kujdesin shëndetësor HF

kohëzgjatja

3 vjet. Arsimimi bëhet me 50% në një ndërmarrje për praktikën dhe me 50% në shkollën e ngritur profesionale.

kushtet e pranimit

arsimim i përfunduar në shkallën e dytë II (kurs zanati trevjeçar, shkolla e mesme ose një arsimim i të njëjtit niveli).

kontakti

Bildungszentrum für Gesundheit und Soziales
Falkenstrasse 2, 8570 Weinfelden, Telefoni 058 345 77 11
www.bfgs-tg.ch → Tertiäre Bildung

SHKOLLA E NGRITUR PROFESIONALE E EKONOMISË

përfundimi

profesioniste e diplomuar në ekonomi ndërmarrjeje HF/
profesionist i diplomuar në ekonomi ndërmarrjeje HF

kohëzgjatja

3 vjet

kushtet e pranimit

arsimim i përfunduar në shkallën e dytë II (kurs zanati tre- ose katërvjeçar, shkolla e mesme ose një arsimim i të njëjtit niveli, të mund të vërtetohet një praktikë profesionale të paktën dyvjeçare në fushën afariste. Në lidhje me njohuritë të anglishtes presupozohet niveli gjuhësor B1 i Kornizës Reference Evropiane.

kontakti

Bildungszentrum Wirtschaft, Weiterbildung
Schützenstrasse 11, Postfach 112, 8570 Weinfelden
Telefoni 058 345 75 75
www.wbbzww.ch → Kursangebot → Wirtschaftsschule
→ Höhere Fachschulen

SHKOLLA E NGRITUR PROFESIONALE E TEKNIKËS SË KONTRUKSIONIT TË MAKINERIVE, THËLLIM TEKNIKË PRODHIMI

përfundimi

technik i diplomuar HF konstruksion makinerie/
teknike e diplomuar HF konstruksion makinerie,
me thellim teknikë prodhimi

kohëzgjatja

3 vjet

kushtet e pranimit

arsimimi profesional bazë i përfunduar si poli-mekanik/-e, konstruktor/-e, automatik/-e ose arsimimi profesional bazë i përfunduar si mekanik/-e prodhimi me dy vjet punë praktike; profesione e të njëjtit niveli pas sqarimit. Një punësim prej të paktën 50% në një veprimtari përkatëse profesionale në fushën mekanike-teknike.

kontakti

Bildungszentrum für Technik
Kurzenerchingerstrasse 8, 8500 Frauenfeld
Telefoni 058 345 65 00
www.bztf.ch → Weiterbildung → HF Maschinenbau → Dipl. Techniker HF

SHKOLLAT E TJERA TË NGRITURA PROFESIONALE

Shkollat e tjera të ngritura profesionale, që ofrojnë një arsimim në fushën e arsimimit të ngritur profesional, gjinden në një distancë që arrihet mirë nga Kantonin Thurgau. Një listë e degëve arsimore HF sipas Kantoneve gjendet në faqen e internetit të Sekretarisë së Shtetit për Arsim, Hulumtim dhe Inovacion SBFi:

www.sbf.admin.ch → Bildung → Höhere Berufsbildung
→ Höhere Fachschulen → Studierende und Absolvierende

Shkollat e larta

Me anë të një studimi drejt kualifikimeve më të mira

Zvicra ka lloje të ndryshme shkollash të larta: shkollat e larta universitare, shkollat e larta profesionale dhe shkollat e larta pedagogjike.

Të parat parimisht veprojnë në hulumtimin e bazave, mbi të cilin ndërtohet edhe mësimi i shkollës së lartë të tyre. Shkollat e larta profesionale përndryshe fokusohen me shumë në praktikën profesionale si dhe në hulumtimin dhe zhvillimin e aplikuar. Shkollat e larta pedagogjike arsimojnë mësues për shkallët e ndryshme shkollore, ofrojnë kualifikim të mëtejshëm dhe zhvillojnë hulumtime në përgjithësi në fushën e shkencës edukative dhe didaktike.

SHKOLLA E LARTË PEDAGOGJIKE THURGAU

Shkolla e vetme e lartë në Kanton është Shkolla e Lartë Pedagogjike Thurgau (PHTG) në Kreuzlingen, ku arsimohen mësues për të gjitha shkallët shkollore. Degët e studimit për shkallën e dytë I dhe II ofrohen në bashkëpunim me Universitetin Konstanz.

KOPSHTI I FËMIJËVE / SHKALLA PARASHKOLLORE

kohëzgjatja

3 vjet. Për absolventet dhe absolventët e Shkollës Pedagogjike me Maturë Kreuzlingen 2 vjet.

kushtet e pranimit

maturë gjimnazi, maturë profesionale me «Passerelle», përfundim i një shkolle të lartë profesionale (eventualisht me detyra shtesë), maturë e specializuar pedagogji, diplomë e një shkolle të mesme trevjeçare profesionale resp. diplome.

SHKALLA E SHKOLLËS SË SHKALLËS SË PARË

kohëzgjatja

3 vjet. Për absolventet dhe absolventët e Shkollës Pedagogjike me Maturë Kreuzlingen 2 vjet.

kushtet e pranimit

maturë gjimnazi, maturë profesionale me «Passerelle», përfundim i një shkolle të lartë profesionale (eventualisht me detyra shtesë), maturë e specializuar pedagogji.

SHKALLA E DYTË I

kohëzgjatja

të paktën 4.5 vjet ose 2 vjet pas fitimit të diplomës arsimore për mësues në shkollën e shkallës së parë. Zgjatja e ndryshueshme e studimit në studim me kohë të pjesshme.

kushtet e pranimit

Maturë gjimnazi resp. diplomë e të njëjtit niveli ose diplomë arsimore e shkallës së parë

SHKALLA E DYTË II

kohëzgjatja

1 vit në studim me kohë të plotë, deri 3 vjet në studim me kohë të pjesshme

kushtet e pranimit

studim universitar profesional në nivelin «Master» (studim me diplomime «Master», «Diplom», «Lizentiat», «Magister») në një lëndë, e cila mësohet nëpër gjimnaze zvicerane.

«MASTER» FËMIJËRI E HERSHME

kohëzgjatja

2 vjet në studim me kohë të plotë, 3 vjet në studim me kohë të pjesshme

kushtet e pranimit

diplomë «Bachelor» e një universiteti, e një shkolle të lartë pedagogjike ose e një shkolle të lartë profesionale në psikologji, pedagogji, pedagogji sociale ose sporti ose në një fushë tjetër studimi përkatëse.

Më shumë informacione rreth degëve të veçanta studimi gjinden në faqen e internetit të Shkollës së Lartë Pedagogjike Thurgau: www.phtg.ch → Studium

SHKOLLA TË TJERA TË LARTA

Zvicër

Kantoni Thurgau është rrethuar me distancë të shkurtër nga një larmi shkollash të larta me një spektër shumë të gjerë degësh studimi. Shkolla të larta të rëndësishme në rajon janë Shkolla e Lartë Profesionale e Zvicrës Lindore (FHO) dhe Shkolla e Lartë për Shkenca të Aplikuar Zürich (ZHAW). Një përmbledhje e të gjitha shkollave të larta universitare, shkollave të larta profesionale dhe shkollave të larta pedagogjike në Zvicër gjinden nën www.swissuniversities.ch.

Për studentët nga Kantoni Thurgau hyrja tek të gjitha shkollat e larta është e siguar me anë të marrëveshjeve ndërkantonale. Sipas këtyre marrëveshjeve, Kantoni Thurgau paguan për studentët e tij kontribute të konsiderueshme (tarifa shkollore).

Konstanz

Për Kantonin Thurgau kanë një rëndësi të madhe Universiteti Konstanz (www.uni-konstanz.de) dhe Shkolla e Lartë për Teknikë, Ekonomi dhe Formim HTWG në Konstanz (www.htwg-konstanz.de). Kualifikim i mëtejshëm dhe oferta shoqëruese

Shkolla e Lartë Ndërkombëtare Bodensee

Selia e kancelarisë së Shkollës së Lartë Ndërkombëtare Bodensee (IBH) ndodhet në Kreuzlingen (www.bodenseehochschule.ch). Kësaj lidhjeje të shkollave të larta i përkasin 30 universitete, shkolla të larta pedagogjike dhe shkolla të larta profesionale rreth e rrotull liqenit Bodensee. Ajo ndër të tjera ofron degë studimi të përbashkëta (veçanërisht në nivelin «Master») dhe kualifikime të mëtejshme të certifikuara.

Kualifikimi i mëtejshëm

Të qëndrosh në temë me anë të kualifikimit të mëtejshëm individual me orientim profesional

Institucione arsimore të panumërta ofrojnë oferta të shumëllojshme në fushën e kualifikimit të mëtejshëm. Ato e nxisin zhvillimin profesional dhe personal.

Ofertat e ndryshme të kualifikimit të mëtejshëm – nga kualifikimi i mëtejshëm profesional tek ofertat e shkollës së lartë deri në arsimimin e përgjithshëm për të rritur – mund të tërhiqen në këtë bankë të dhënash:

www.berufsberatung.ch → Aus- und Weiterbildung → Weiterbildung – Kurse, Lehrgänge

Oferta shoqëruese për të gjitha shkallët shkollore

ARSIMIMI I PRINDËRVE

Arsimimi i prindërve u drejtohet nënave dhe baballarëve, gjysheve dhe gjyshërve si dhe të interesuarve të tjerë, të cilët bashkëjetojnë me fëmijë. Arsimimi i prindërve forcon persona edukues në detyrën e tyre dhe tregon, sesi fëmijët zhvillohen dhe sesi ai zhvillimi mund të përkrahet. Arsimimi i prindërve merr parasysh burimet e personave edukues dhe synon një kontakt të kujdesshëm dhe respektues.

Grupi i Punës e Kantonit Thurgau për Organizatat e Prindërve (TAGEO) është çatia kantonale koordinuese e organizatave rajonale dhe lokale të prindërve. Dy herë në vit botohen oferta përkatëse për prindër në Kalendarin për Arsimimin e Prindërve TAGEO. Ky mund të këqyret nën: www.tageo.ch → Eltern & Bildung

PSIKOLOGJIA SHKOLLORE DHE LOGOPEDIA

Në rast vështirësie brenda kontekstit shkollor mund të shfrytëzohet një shqyrtim falas tek psikologu shkollor ose tek logopedisti. Prindërit dhe shkolla marrin udhëzime për trajtimin e anëve të forta dhe të dobëta të një fëmije si dhe rekomandime për masa të përshtatshme nxitimi. Oferta u referohet fëmijëve dhe adoleshentëve nga fëmijëria e hershme deri në moshën 18 vjeç.

Informacione të tjera gjinden në faqen e internetit të Entit për Shkollën Popullore: av.tg.ch → Angebote und Beratung → Schulpsychologie und Logopädie

Regionalstelle Amriswil (Zyra rajonale Amriswil)

Kirchstrasse 1, 8580 Amriswil, Telefoni 058 345 74 60

Regionalstelle Frauenfeld (Zyra rajonale Frauenfeld)

Grabenstrasse 11, 8510 Frauenfeld, Telefoni 058 345 74 30

Regionalstelle Kreuzlingen (Zyra rajonale Kreuzlingen)

Konstanzerstrasse 13, 8280 Kreuzlingen, Telefoni 058 345 74 80

KONSULTIMI PËR PROFESION DHE STUDIME

Konsultimi për profesion dhe studime i ndihmon adoleshentët dhe të rriturit përmes informacioneve dhe konsultimit personal gjatë zgjedhjes së profesionit dhe të studimit si dhe gjatë formimit të karrierës profesionale.

Informacione të tjera gjinden në faqen e internetit të Entit për Formim Profesional dhe Konsultim për Zanat: abb.tg.ch → Berufs- und Studienberatung BIZ

Qendrat informuese për profesione (BIZ)

BIZ-i është zyra ku mund të drejtohesh për të gjitha pyetjet rreth zgjedhjes së një profesioni, rreth studimit dhe rreth karrierës.

orari

të hënën deri të mërkurën	ora 08:00 deri në orën 11:30 ora 13:30 deri në orën 17:30
të enjten	ora 08:00 deri në orën 11:30 ora 13:30 deri në orën 19:00
të premten	ora 08:00 deri në orën 11:30 ora 13:30 deri në orën 17:00

Berufs- und Studienberatung Amriswil

Rütistrasse 7, 8580 Amriswil, Telefoni 058 345 59 80
biz-amriswil@tg.ch

Berufs- und Studienberatung Frauenfeld

Zürcherstrasse 285, 8510 Frauenfeld, Telefoni 058 345 59 55
biz-frauenfeld@tg.ch

Berufs- und Studienberatung Kreuzlingen

Schützenstrasse 1, 8280 Kreuzlingen, Telefoni 058 345 59 70
biz-kreuzlingen@tg.ch

Berufs- und Laufbahnberatung Wil SG

Obere Bahnhofstrasse 20, 9500 Wil, Telefoni 058 229 05 20
info.blbwil@sg.ch

Vetëm për adoleshentët nga komunat shkollore:

Affeltrangen, Bichelsee-Balterswil, Eschlikon, Fischeningen, Rickenbach-Wilen, Sirnach dhe Schönholzerswilen

KONTRIBUTE PËR ARSIMIMIN DHE KONTRIBUTE NË SHKOLLA JASHTË KANTONIT

Bursa dhe kredi

Nëse mundësitë financiare nuk mjaftojnë për arsimimin, Kantoni mund të mbështesë me bursa dhe kredie. Bursat miratohen normalisht për arsimime parësore në shkollën e dytë II (kurs zanati, shkolla të mesme etj.) dhe në shkollën e tretë (studime në shkolla të ngritura profesionale dhe shkolla të larta). Kreditë hyjnë veçanërisht në punë edhe tek arsimimet dytësore.

Vendimtare për llogaritjen janë raportet financiare (vërtetimi i taksave) të prindërve resp. të parashtruesit të kërkesës ose të parashtrueses së kërkesës vetë.

Informacione të tjera gjinden në këtë faqe interneti:

stipendien.tg.ch

Pagesat shkollore

Me anë të marrëveshjeve të ndryshme rajonale dhe ndërkantonale është siguruar, që banueset dhe banuesit e Kantonit Thurgau të kenë një rrugë të hapur drejt të gjitha arsimimeve të rëndësishme, që Kantoni nuk i ofron vetë dhe të cilët për shkak të kësaj duhet të kryhen tek institucione jashtëkantonale. Derisa arsimimet janë të akredituar brenda Zvicrës dhe/osa brenda Kantonit dhe derisa janë të përfshirë në një marrëveshje, Kantonit Thurgau merr përsipër pagesën shkollore (të mos të ngatërrohet me tarifat e semestrit, të cilat duhet të paguhen nga studentet dhe studentët vetë). Në rastet, kur një banuese ose një banues të Kantonit Thurgau për një arsimim të akredituar ka për të mbajtur një pagesë shkollore më të madhe se studentët prej Kantonit ku ndodhet shkolla, Kantonit i shpërblen këto kosto shtesë, në qoftë se brenda Kantonit nuk ekziston një ofertë e krahasueshme.

Informacione të tjera gjinden nëpërmjet kësaj faqe interneti:

stipendien.tg.ch

INFORMACIONE TË TJERA DHE INSTITUCIONE KU MUND TË DREJTOHESH

Departement für Erziehung und Kultur (DEK)

Regierungsgebäude, 8510 Frauenfeld
Telefoni 058 345 57 50, Fax 058 345 57 51
dek@tg.ch, dek.tg.ch
Rechtsbuch online: www.rechtsbuch.tg.ch

Amt für Volksschule (AV)

Spannerstrasse 31, 8510 Frauenfeld
Telefoni 058 345 57 70
info.av@tg.ch, av.tg.ch

Amt für Berufsbildung und Berufsberatung (ABB)

Zürcherstrasse 285
8510 Frauenfeld
Telefoni 058 345 59 30, Fax 058 345 59 31
abb@tg.ch, abb.tg.ch

Amt für Mittel- und Hochschulen (AMH)

Grabenstrasse 11, 8510 Frauenfeld
Telefoni 058 345 58 30, Fax 058 345 58 31
amh@tg.ch, amh.tg.ch